



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:291018
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05842842

PAKR.nr.294/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi – kryetar i kolegjit, Bashkim Hyseni dhe Xhevdet Abazi - anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Syzana Goxhuli, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.N, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, duke vendosur në lidhje me ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë si dhe përgjigjen në ankese e PTH-së nga mbrojtësi i të akuzuarit B.N, av.Haxhi Sinanaj, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.20/24 i datës 30.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK, me datë 19.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë- Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.20/24 i datës 30.04.2024, **NDRYSHOHET** përkitazi me vendimin mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin B.N për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së e Gjykon me dënim me burgimi në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim policor nga data 15.12.2023 deri me 17.12.2023, dhe të cilin dënim duhet ta mbaj pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, ndërsa dënimi me gjobë prej njëmijë (1000) euro merret si i vërtetuar, në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pa ndryshuar.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.20/24 i datës 30.04.2024, të akuzuarin B.N, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj, si dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 Euro.

Konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit dënimi i shqiptuar me burgim prej gjashtë (6) muajsh, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej gjashtëmijë (6000) Euro, të njëjtit:

Në aplikim të nenit 76 par.2 nënpar.2.4 lidhur me par.1 të KPPRK-së i shqiptohet, dënim unik me gjobë në shumë prej shtatëmijë (7000) €, duke i llogaritur kohën e kaluar në ndalim policor nga data 15.12.2023 deri me 17.12.2023.

Është obliguar i pandehuri, që dënimin me gjobë në shumë prej shtatëmijë (7000) €, ta paguaj me këste në afat prej tre (3) muaj, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, duke filluar nga data 01 deri me datën 05, të çdo muaj vijues.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, një ditë burgim llogaritet me njëzet (20) Euro gjobë. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Është obliguar i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej njëzet (20) €, ndërsa në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) €, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform 267 par.5 të KPPRK-së të pandehuri i janë konfiskuar 5 (pesë) copë cigare (xhointa) të mbushura me substancë bimore të llojit M... në peshë neto prej ... gram; 2 (dy) qese plasmasi të mbushura me substancë bimore ngjyrë të gj.. e llojit M... në peshë neto prej 336.1 gram, 1 (1) një qese plasmasi me substancë bimore ngjyrë të gj..e llojit M... në peshë neto prej .. gram, 1

boks i hekurt, si dhe një tubë plastike, ngjyrë e zezë, sipas vërtetimi mbi sekuestrim të përkohshëm të sendeve nën shenjën R-2023-XI-DKKO-HTN-PE-107 të datës 15.12.2023.

Urdhërohet 5 (pesë) copë cigare (xhointa) të mbushura me substancë bimore të llojit M... në peshë neto prej 6.4 gram; 2 (dy) qese plasmasi të mbushura me substancë bimore ngjyrë të gj... e llojit M... në peshë neto prej 336.1 gram, 1 (1) një qese plasmasi me substancë bimore ngjyrë të gj.e llojit M... në peshë neto prej gram, 1 boks i hekurt, si dhe një tubë plastike ngjyrë e zezë, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të shkatërrohen.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Pejë, për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim Gjykata e Apelit e Kosovës, ta aprovoi ankesën e prokurorisë ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj ashtu që të akuzuarit ti shqiptoj dënim me të rendë.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit B.N, av.Haxhi Sinanaj më propozim që ankesa e prokurorisë të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktgjykim i ankimuar të vërtetohet.

Prokurori i Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.275/2024, datë 21.05.2024, ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë si e bazuar, ndërsa aktgjykimin i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me të rendë, ndërsa përgjigja në ankese e PTH-së e ushtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit B.N, av.Haxhi Sinanaj të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit e caktoi dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPK-se në të cilën nuk morën marrë pjesë asnjëra nga palët, Prokurori i Apelit, i akuzuari B.N dhe mbrojtësi i tij av.Haxhi Sinanaj edhe pse kanë qenë të njoftuar në mënyrë të rregullt nuk morën pjesë në seancë.

Gjykata e Apelit, analizoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësit e të akuzuarit dhe pas analizimit dhe vlerësimit të tyre gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtën e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare edhe në këtë aspekt konform nenit 394 par.1 të KPPK-së, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të tjera të cilat detyrimisht do të kushtëzonin prishjen e tij.

Po ashtu, me ankesë nuk kontestohet as gjendja faktike të cilën e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë, prandaj as në këtë drejtim çështja nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj Gjykate (pasi që nuk mund të kontestohet aktgjykimi përkitazi me këtë bazë ankimore ngase i akuzuar e ka pranuar fajësinë, kurse aktgjykimi u vlerësua vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore sa i përket vendimit mbi dënim.

Pretendimet e prokurorit në ankesë

Prokurori në ankesë thekson se gjykata me rastin e trajtimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese gjykata përveç që nuk i ka konstatuar saktë propozimet e Prokurorisë të deklaruara gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, gjykata ka shtuar edhe rrethana tjera lehtësuese për të akuzuarin, e të cilat Prokuroria fare nuk i ka propozuar, kjo vërtetohet me procesverbalin e seancës së shqyrtimit fillestar ku në faqe 4/5 rreshti nr.15, është konstatuar citoj “Prokurori i Shtetit deklaroi i pandehuri më parë nuk është dënuar me aktgjykim të formës së provë, kjo vërtetohet nga ekstrakti mbi dënimet E1/277/2024/DEQP/KGJK. Gjykatës i propozoj që si rrethanë rënduese të merr shkallën e lartë të dashjes, kurse si rrethanë lehtësuese faktin se i njëjti sot e pranoj fajësinë dhe si rrethanë që i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar”.

Kurse në aktgjykimin e Gjykatës me nr. PKR.nr.20/24, dt.30.04.2024, fq.4/5 rreshti nr.4, gjykata ka konstatuar, citoj: “Prokurorja e Shtetit me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim i ka propozuar Gjykatës, që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin të ketë parasysh; pranimin e fajësisë, mos dënueshmërinë e tij sipas vërtetimit të KGJK të datës 23.02.2024, sjelljen korrekte të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës penale, moshën e tij të re, pendimin për kryerjen e veprës penale, është hera e parë që ka ra ndesh me Ligjin, ndërsa rrethanë rënduese ka thënë se qëndron pranë rrethanave rënduese të konstatuara në faqe 4 të aktakuzës” !!!

Sipas Prokurorisë, ky konstatim ka ndikuar shume në vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese nga gjykata, ashtu që me rastin e marrjes se vendimit mbi dënimin, gjykata nuk ka

bërë peshim objektiv të gjitha rrethanave të propozuara nga prokuroria e të cilat do të kishin ndikuar në matjen e saktë të dënimit, sepse rrethanat e vlerësuara nga Gjykata kanë ndikuar negativisht në matjen e dënimit duke i mbipeshuar rrethanat lehtësuese, e posaçërisht pranimin e fajësisë të akuzuarit të bërë gjatë shqyrtimit fillestar, ku Gjykata këtë pranim e ka vlerësuar edhe si rrethanë lehtësuese edhe si rrethanë posaçërisht lehtësuese, kurse rrethanën renduese të propozuara nga Prokuroria si shkallën e lartë të dashjes, gjykata fare nuk e ka vlerësuar, e që ky vlerësim i tillë ka rezultuar me një vendim për dënimin që nuk i përgjigjet arritjes së qëllimit të dënimit.

Ky dënim i bute i shqiptuar nga Gjykata përveç që nuk i përgjigjet arritjes së qëllimit të dënimit, i njëjti nuk mund të ndikoj në parandalimin e kryesit këtu të akuzuarit, për kryerjen e veprave penale në të ardhmen, nuk mund të ndikoj tek personat e tjerë që të mos kryejnë vepra penale, e po ashtu ky dënim i shqiptuar nuk është në proporcion me peshën e veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, që është shëndeti i të rinjve.

Sa i përket zëvendësimit të dënimit me burgim me atë me gjobë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se „Konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit dënimi i shqiptuar me burgim prej 6 muajsh i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 6000 euro”. Kjo prokurori ka analizuar aktgjykimin PKR.nr.20/24 të dt.30.04.2024, dhe askund nuk kemi gjetur konstatimin e gjykatës se i pandehuri me dt.19.04.2025 në ora 13:15 kur edhe është shpallur aktgjykimi të ketë dhënë pëlqim për zëvendësimin e dënimit me burg në atë me gjobe, ashtu konsiderojmë se gjykata me rastin e zëvendësimit të dënimit me burgim në atë me gjobe ka vepruar në kundërshtim me nenin 44 të KPRK.

Andaj konsideron se në rastin penal konkret nuk janë vlerësuar drejtë rrethanat e konstatuara, andaj duke pasur parasysh të lartcekurat, Gjykata e shkallës së parë është dashur që ndaj të akuzuarit të lartcekur të shqiptojë dënim më të rëndë përkitazi me rrezikshmërinë e vlerave të mbrojtura shoqërore, shkallen e lartë të dashjes së tij, e i cili dënim më të vërtetë do të arrinin qëllimin e dënimit, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.N, av.Haxhi Sinanaj, në përgjigje në ankesë thekson se pretendimet e prokurorisë janë të pa bazuara për faktin se gjykata nuk është e kufizuar vetëm në propozimet e palëve lidhur me rrethanat lehtësuese dhe renduese, por që ky vlerësim është në kompetencë të

plot të gjykatës e cila ka konstatuar se ekzistojnë rrethana lehtësuese të shtjelluara në aktgjykim, andaj për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorit për shqiptimin e dënimit me të mendë janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese, duke i përcaktuar të akuzuarit dënim nën minimumin ligjor prej gjashtë (6) muaj burgim dhe më pas të njëjtin dënim e ka zëvendësuar në dënim me gjobë në lartësi prej gjashtëmijë (6000) Euro.

Kolegji vlerëson se dënimi i shqiptuar nuk është proporcional me peshën konkrete të veprës penale, rrethanave të kryerjes, pasi që të akuzuarit i'u kanë gjetur narkotikë e llojit marihuan në peshë të përgjithshëm prej, gram edhe përkundur ekzistimit të rrethanës veçanërisht lehtësuese pranimin fajësisë, dhe rrethanave të tjera lehtësuese të cituar, dënimi i shqiptuar është i pamjaftueshëm për të arritur qëllimin ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjeneralë.

Kolegji rikujton se vepra penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, është e dënueshme me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet.

Dënimet e shqiptuara në parim duhet të jenë në kuadër të kornizave të përcaktuara nga ligjvënësi, diskrecioni i gjyqtarëve duhet të ushtrohet në harmoni me të gjitha rrethanat konkrete të çështjes dhe të vlerësimit objektiv të rrethanave si lehtësuese dhe rënduese, në rastin konkret rrethanat rënduese nga gjykata e shkallës së parë nuk janë marrë parasysh si sasia e narkotikut, që ka rezultuar me faktin që të caktohet një dënim nën minimumin ligjor të përcaktuar për veprën penale dhe më pas ti zëvendësohet në donim me gjobë/

Kolegji konsideron se në aktgjykimin e atakuar nuk është bërë një peshim objektiv i të gjitha rrethanave të cilat ndikojnë në matjen e dënimit, por janë mbipeshuar rrethanat lehtësuese në përcaktimin e dënimit që ka rezultuar në një vendim mbi dënimin që nuk i përgjigjet perspektivës së arritjes së qëllimit të dënimit.

Kolegji vlerëson se dënimi i shqiptuar tani si në dispozitiv të këtij vendimi është në proporcion me peshën konkrete të veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, rrethanave të kryerjes, pasojave të shkaktuara si dhe me bindjen se dënimi do të ndikoj në parandalimin për kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale.

Nga arsyet e sipërcekura dhe në bazë të nenit 403 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR 294/2024, datë 19.06.2024

Bashkëpunëtore Profesionale, Anëtarët e kolegjit,

Kryetar i kolegjit,

Syzana Goxhuli

Bashkim Hyseni

Burim Ademi

Xhevdet Abazi